



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian

E - buletini no.18

Korrik 2019

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Aksioni për Zhvillim Rural (AZR) dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret parasysh për të pasqyruar mendimet e Bashkimit Evropian



**Parlamenti Kombëtar Rural
si Zëri i Banorëve Rural**

'Kosta Veselinov' 3a,
1000 Skopje
R. Macedonia
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk
zg.akrra@yahoo.com

Organizatrat e implementimit





Parlamenti Rural Kombëtar i parë në Republikën e Maqedonisë së Veriut



Në periudhën prej 12-14 qershor 2019, në Republikën e Maqedonisë së Veriut ishte organizuar Parlamenti Rural Kombëtar i parë, duke ndjekur shembullin pozitiv të vendeve evropiane që me vite të tëra organizojnë parlamente rurale si proces efikas të përfshirjes dhe diskutimit mes popullatës rurale dhe kreatorët e politikave me qëllim të përmirësimit të politikave rurale dhe adresim të problemeve të caktuara lidhur me zhvillim rural.

Më tepër se 90 përfaqësues të organizatave lokale qytetare, organizata ndërkombëtare, sektori afarist, vetëqeverisja lokale, Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, janë takuar në Krushevë në parlamentin e parë rural në Maqedoninë e Veriut dhe kanë pasur mundësi të ndajnë njohuri dhe përvoja në tema të ndryshme nga fusha e zhvillimit rural të adresuar me anë të panel diskutimit dhe punës në grupe. Qëllimi i parlamentit rural është krijimi i një platforme kombëtare e organizatave rurale qytetare që do të jetë në mënyrë aktive e përfshirë në krijimin e strategjive dhe politikave për zhvillim rural në nivelin lokal dhe kombëtar.





Me Parlamentin Rural Kombëtar të parë ishte përmblytur projekt i trevjeçar "Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale", mbështetur nga BE, dhe zbatuar nga tre organizata: CNVP – Organizata për Lidhje të Vlerave Natyrore dhe Njerëzve, RZR i RM - Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë dhe AkRRa – Aksioni për Zhvillim Rural. Përveç drejtimeve të kryetarit të Rrjetit për Zhvillim Rural – Petar Gjorgievski dhe drejtuesi i projektit dhe drejtor i CNVP – Anela Stavrevska Panajotova, fjalime të tyre kishin edhe: shefi i kabinetit të Ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit – Trajan Dimkovski, kryetari i komunës së Krushevës - Tome Hristovski, eksperti për zhvillim rural - Sofija Davidova, kryetari i PREPARE - Aris Adlers, sekretari i përgjithshëm i Grupit të Përhershëm të Punës për Zhvillim Rural të Evropës Juglindore SWG - Boban Iliq, Stole Georgiev nga Grupi Lokal i Aksionit Pllaçkovicë dhe profesor dr. Jorde Jakimovski nga Instituti për Hulumtime Sociologjike, Politike dhe Juridike.

«Qëllimi është të përfshijmë këto organizata që mund të jenë ndihmë rreth krijimit të politikave, sepse shteti nuk mund të arrijë me prioritetet e secilës komunë, secili rajon i planifikimit ka prioritet të ndryshëm dhe pikërisht për këtë organizatat qytetare mund të jenë partner i mirë i shtetit që është krijuar i politikave», theksoi Anela Stavrevska Panajotova, Drejtor i CNVP.

“Shpresojmë që në ardhmen do të përfshihet edhe Ministria e Bujqësisë në organizim të përbashkët të Parlamentit Rural Kombëtar sepse vetëm me qasje të përbashkët të sektorit qytetar dhe autoritetet mund bashkërisht të kontribuohet për përmirësim të jetës në mjediset rurale», theksoi Petar Gjorgievski, kryetar i Rrjetit për Zhvillim Rural i Maqedonisë.

Pjesëmarrësit e parlamentit kanë pasur mundësi të diskutojnë dhe të adresojnë çështje me anë të punës në grupet tematike:

- Tema 1: Mundësi për punësim të rinjve, grave dhe kategorive tjera të cenuar në viset rurale
- Tema 2. LEADER programi
- Tema 3. Diversifikimi rural
- Tema 4. Bujqësia e qëndrueshme dhe praktikat

Konkluzionet dhe rekomandimet e miratuara në kuadër të këtyre grupeve të punës ishin më tutje të përfshirë në produktin e fundit të Parlamentit Rural Kombëtar - Manifestin. Ky Manifest, që në mënyrë zyrtare do të dërgohet tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekon-



omisë së Ujit, si dhe institucione tjera relevante, i jep udhëzimet kryesore dhe prioritetet në të cilat duhet të orientohet politika rurale.

Parlamenti Rural Kombëtar i parë ka përfunduar me vizita në teren, ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë që shikojnë shembuj pozitiv për sipërmarrje rurale, turizëm rural dhe alternativ, potenciale natyrore dhe resurse në rajonet e Prespës dhe Mavraro-Rostushe, si dhe të shijojnë specialitete të kuzhinës tradicionale maqedonase. Në këto takime me popullatën rurale ishin shkëmbyer përvoja dhe qëndrime në lidhje me qëndrueshmërinë dhe mirëqenien e viseve rurale.



Punëtori tematike për përcaktim të temave prioritare mbi zhvillimin e viseve rurale



Në periudhën prej shkurt deri prill 2019 në kuadër të projektit “Parlamenti Rural Kombëtar si Zëri i Popullatës Rurale” ishin realizuar punëtori në shtatë rajonet e planifikimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me anë të diskutimit të përbashkët të gjitha palëve të përfshirë në zhvillimin rural, të pranishmit në punëtoritë kanë pasur mundësi të shprehin qendrimet e tyre dhe këndvështrimet në pjesën e zhvillimit rural. Entuziazmi, natyra pozitive dhe fryma e lumtur në drejtim të krijimit të një të nesërme më të mirë kanë ndihmuar për motivim më të gjerë në përcaktimin e temave prioritare.

Me anë të këtyre punëtorive janë përcaktuar edhe tema prioritare për zhvillim të viseve rurale në secilin rajon individualisht, dhe pastaj është bërë një përmbledhje të prioriteteve dhe sfidave të gjitha rajoneve të planifikimit që ishin pjesë e diskutimit në Parlamentin Rural Kombëtar të parë.





Nga diskutimet e përbashkëta, në mentorim të projektit, ishin veçuar prioritetet vijuese:

Nr.	Tema prioritare
1	Qasje të lehtësuar në burime të financimit për investime të reja
2	Përmirësimi i mundësive për punësim dhe/ose fillim të biznesit për të rinjtë
3	Përmirësimi i kushteve sociale ekonomike
4	Zhvillimi i turizmit rural
5	Zhvillimi i prodhimit organik
6	Zhvillimi i bujqësisë
7	Qasje të përmirësuar në ngjarje dhe aktivitete kulturore
8	Qasje më të mirë në kopshte për të fëmijë
9	Qasje më të mirë dhe përmirësuar në shërbime shëndetësore
10	Plasman më të mirë dhe funksionim të tregut
11	Efikasitet më të mirë të prodhimit
12	Kushte të përmirësuara të punës në bujqësi, pylltari dhe turizëm
13	Investim në teknologji dhe praktika inovative në biznesin
14	Shërbime të përmirësuara financiare dhe të sigurimit
15	Përdorimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore
16	Mbështetje të zhvillimit të pylltarisë
17	Nxitje të shoqërimit dhe modelit shoqëruar
18	Qasje të përmirësuar në njohuri dhe informacione
19	Përmirësim i infrastrukturës rurale

Në punëtoritë kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të sektorit publik dhe qytetar, dhe ato, përveç që kanë marrë pjesë në përcaktimin dhe renditjen e prioriteteve në viset rurale, kanë pasur mundësi që të njohohen me dokumente të shkurta për politika, që ishin përpiluar nga organizatat që gjenden në rajonet e planifikimit.





Në kuadër të Programit për Ri-Grantim të projektit “Parlamenti Kombëtar Rural si Zëri i Popullatës Rurale” ishin aprovuar 10 projekte. Periudha e zbatimit të tyre është prej shtator 2018 deri më janar 2019.

Titulli i projektit:

“Përforcimi ekonomik i grave rurale nga përkatësitë
etnike të ndryshme të Rajonit Lindor dhe Perëndimor”

Organizata:

Shoqata e Fermerëve Gra
AGRO-VINKA Vinicë

Partner:

Shoqata Radika-De Dibër

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Me anë të themelimit të bashkëpunimit të mirë dhe shkëmbimit të përvojave, edukim, promovim dhe bashkëpunim dhe përpjekje të përbashkëta të nxisim të rinjtë dhe gratë të përkatësisë së ndryshme etnike të Rajonit Lindor dhe Perëndimor (komunat Vinicë, Dbiër, Mavrovë Rostushë dhe Centar Zhupa) të njohin bazat e sipërmarrjes dhe artizanisë, të ndajnë përvoja në dy rajonet, të zhvillojnë ide të tyre të biznesit dhe në këtë mënyrë të rrisin mundësitë për pavarësi ekonomike.

Qëllimi specifik i projektit:

Përmirësimi i kushteve për zhvillim dhe përforcim ekonomik të grave dhe të rinjve dhe krijimi i kushteve për informim më të mirë për mundësitë dhe konkurrencën që ofron rajoni.

Aktivitetet:

Aktivitetet për intensifikim të bashkëpunimit mes grave të rinjve nga dy rajonet, me anë të zbatimit të trajnimit për zhvillim të përbashkët, shkëmbim të përvojave dhe ngritjes së kapaciteteve;

1. Organizimi i një seminary dyditor nga fusha e sipërmarrjes, zhvillimit të ideve për biznes dhe përgatitje të planit për biznes;
2. Organizimi i një punëtori kreative treditore praktike nga fusha e artizanisë;
3. Përgatitja dhe shtypja e materialeve për promovim;
4. Organizimi i ngjarjes përfundimtare në të cilën do të promovohen idetë e biznesit në standat e tyre;
5. Rimëkëmbja e ueb faqes së shoqatës Agro-Vinka nga Vinica.



Rezultate:

1. Janë trajnuar 30 persona për bazat e artizane edhe sipërmarrjes, përgatitja e planit për biznes dhe zhvillimit të idesë për biznes, thurje me monistrë, teknikë filc dhe endje;
2. Janë nxitur së paku 20% të pjesëmarrësve të fillojnë biznesin e tyre;
3. Ngjarje e fundit me Pazar të rreth 50 produkte të punuara me dorë gjatë trajnimeve praktike;
4. Shkëmbim i kontakteve për shitje të punime edhe komunikim më të mirë dhe bashkëjetesë mes komuniteteve të ndryshme etnike;





Titulli i projektit:

Të Drejtë ndaj Natyrës

Organizata:

Shoqata e Qytetarëve
EKOVITA

Partner:

Shoqata e Prodhuesve të
Ushqimit Organik Biovita – Kavadar

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Prodhimtaria organike, mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i mjedisit jetësor në viset rurale.

Qëllimi specifik i projektit:

- rrjetëzimi i palëve të interesuara të sektorit bujqësor në viset rurale (fermerë rural, fermer, përpunues, turistë, hotelier, blerës, trupa të certifikuar, trajner, dhe tjerë);
- zhvillimi i konceptit që do të sigurojë kthim të kultivimit tradicional të kulturave bujqësore, me lloje dhe tipa që janë autoktone dhe të adaptuar kushteve mikro-klimatike që ekzistojnë në rajonet rurale të Rajonit të Tikveshit;
- trajnim dhe certifikim të kulturave tradicionale bujqësore në viset rurale, për prodhimtari të produkteve organike;
- plasman i siguruar i kulturave bujqësore në kapacitete përpunuese.

Aktivite:

1. Analiza e terreni dhe përcaktimi i prodhuesve bujqësor që kanë sipërfaqe për organizim të prodhimtarisë organike në viset rurale të Rajonit të Tikveshit.
2. Përgatitje të manualit për prodhimtari organike, në nivelin fillestar.
3. Organizim i punëtorisë në temën e parimeve themelore të prodhimtarisë organike për prodhues primar, përpunues, tregtarë me prodhime organike, tregtarë me prodhime bujqësore, hotelier dhe konsumatorë të ushqimit të shëndetshëm.
4. Përcaktimi i prodhuesve që posedojnë kapacitete për organizim të prodhimtarisë organike.
5. Trajnim në temë "Teknika të kultivimit të kulturave specifike sipas parimeve të prodhimtarisë organike".



Rezultate:

- 10 fermerë të trajnuar dhe certifikuar, që produktet e tyre do të prodhojnë në tregun lokal
- Manual për prodhimtari organike në nivelin fillestar
- Prodhimtari konkurruese të produkteve me vlerë të shtuar, me certifikim të sipërfaqeve në përputhje me parimet e prodhimtarisë organike
- Ngritja e vlerës ekonomike të prodhimtarisë rurale me anë të sigurimit të plasmanit të produkteve

Mbijetesë të popullatës bujqësore në rajonet rurale, në mënyrë që siguron qëndrueshmëri të mjedisit jetësor dhe llojllojshmërisë biologjike.





Titulli i projektit:

Përforcimi i kapaciteteve të organizatave qytetare për arritjen e nivelit më të lartë të qëndrueshmërisë dhe fuqisë së përfaqësimit

Organizata:

Shoqata e Prodhuesve të Llojeve Kopshtare dhe të Luleve "HORTI EKO", Strumicë

Partner:

Shoqata për qëllime arsimore-edukative DM LENGUIX-HES

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Përforcimi i mjedisit aktiv të shoqërisë qytetare, që do të kontribuojë për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e organizatave qytetare në vend si aktorë pro aktiv social.

Qëllimi specifik i projektit:

Të rritet kapaciteti i anëtarëve të ZPGCV "Horti Eko" Strumicë dhe DM Lenguixhes që do të mundësojë njohjen tyre, si partnerë kryesor për përfaqësimin e interesave të banorëve rural në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar.

Aktivite:

1. Pjesëmarrje aktive në zbatimin e programit për trajnim të 2 organizatave qytetare për përforcim organizativ;
2. Dizajni dhe zbatimi i fushatës për informim për qasje të shoqëruar të popullatës rurale;
3. Organizimi i tryezës së rrumbullakët me gjithë aktorët e sektorit, për të mundësuar pjesëmarrje dhe afrim i aktorëve lokale në bujqësi dhe proceset e përmirësimit të gjendjes me regjistrimin e fermerëve dhe formalizmin e aktiviteteve të tyre bujqësore;



Rezultate:

1. Përforcimi i kapaciteteve të 2 shoqatave bujqësore – ZPGCV "Horti Eko", Strumicë dhe DM Lenguixhes me anë të një pako intensive të trajnimit për planifikim afarist dhe ekonomik në bujqësi.
2. Rritje të vetëdijes për përparësitë e aktiviteteve shoqërore dhe mundësive për zhvillim pjesëmarrës dhe shoqëror të fermerëve. Me anë të shoqërimit të shoqatave bujqësore dhe kooperative krijohen kushte themelore për rritje të konkurrencës, mundësi për fuqi më të madhe të negociatave të fermerëve, cilësisë dhe komercializimit të prodhimtarisë bujqësore në Maqedoninë e Veriut.
3. Janë themeluar mekanizma efektive për afrim dhe përmirësim të bashkëpunimit mes organizatave qytetar dhe autoritetet lokale.





Titulli i projektit:

E-portal turistik të rajoneve rurale të Rajonit Verilindor

Organizata:

Shoqata për mbrojtjen e mjedisit kulturor, atraksionet kulturore-turistike dhe shëndetin e njeriut IZVOR Kratovë

Partner:

Shoqata EKOKRATER KRATOVO – Kratovë

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Përmirësimi i bashkëpunimit mes OJQ dhe pushtetit lokal, sektorit afarist dhe popullatën lokale me qëllim të përfshirjes së ndërsjellë në proceset e zhvillimi rural në Komunitat Kratovë, Staro Nagoriçane, Rankovce dhe Kriva Pallankë.

Qëllimi specifik i projektit:

1. Përforcimi i kapaciteteve të OJQ për drejtim financiar në viset rurale;
2. Promovimi i trashëgimisë kombëtare dhe kulturore në rajonet rurale të rajonit verilindor;
3. Zhvillimi i sektorit afarist në fushën e turizmit rural;
4. Krijimi dhe zbatimi i ofertave turistike për të përforcuar ndikimin e OJQ-ve në procesin e rritjes socio-ekonomike të mjediseve rurale;
5. Themelimi i mekanizmit të qëndrueshëm për krijimin e partneriteteve mes OJQ, sektorin afarist dhe popullatën lokale.



Aktivitete:

1. Organizim i ngjarjes publike për informim të publikut për qëllimet, përmbajtjen dhe përfitimet e projektit;
2. Përgatitja dhe organizimi i dy punëtorive në temën "Standardet turistike në viset rurale";
3. Hulumtimi dhe mbledhja e të dhënave të nevojshme për përgatitjen e E-Portalit Turistik të viseve rurale të rajonit Verilindor;
4. Përgatitja e E-Portalit Turistik të viseve rurale të rajonit Verilindor;
5. Organizimi dhe realizimi i ngjarjes përmblylëse

Rezultate:

1. Informim të palëve të interesuara lokale;
2. Ngritje e vetëdijes së popullatës lokale për dhënien e shërbimeve në kuadër të turizmit rural;
3. Krijimi dhe përdorimi i E-Portalit Turistik të viseve rurale të rajonit Verilindor në gjuhën maqedonishte dhe anglisht.
4. Promovimi i furnizuesve të shërbimeve turistike.





Titulli i projektit:

Me anë të veprimit të përbashkët dhe përfaqësim deri në biznes të suksesshëm për fermerët në Likovë dhe Staro Nagoriçane

Organizata:

Shoqata Multietnike dhe Joqeveritare e Grave "Linda" Kumanovë

Partner:

Fondacioni për Zhvillim të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Kumanovë

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Kontribut për themelimin e praktikave për zgjidhjen e problemeve me të cilat përballohen fermerët dhe popullata lokale në komunat rurale të Likovës dhe Staro Nagoriçane.

Qëllimi specifik i projektit:

Rritja e nivelit të veprimit të përbashkët të organizatave qytetare në përfaqësim dhe adresim të problemeve me të cilat përballohen fermerët dhe popullata lokale në komunat rurale të Likovës dhe Staro Nagoriçane

Aktivite:

- Organizimi i trajnimit për menaxhim organizativ dhe punë të shoqatave;
- Organizimi i trajnimit për përgatitje të projekteve të BE-së;
- -Organizimi i trajnimit për përfaqësim dhe rrjetëzim;
- Takime të rregullta koordinuese;
- Organizimi i 4 seancave informative në 4 vendbanime në komunat e Likovës dhe Staro Nagoriçane;
- Organizimi i dy trajnimeve për inovacione në bujqësi dhe biznes;
- Zgjedhja e 2 ideve më të mira afariste nga dy komunat;



- Përpilimi i planeve afariste për idetë më të mira;
- Organizimi i 4 seancave informative në 4 vendbanime në komunat e Likovës dhe Staro Nagoriçane;
- Organizimi i dy trajnimeve për inovacione në bujqësi dhe biznes;
- Zgjedhja e 2 ideve më të mira afariste nga dy komunat;
- Përpilimi i planeve afariste për idetë më të mira;
- Dorëzimi i iniciativave tek vetëqeverisja lokale dhe institucionet kombëtare.

Rezultate:

1. Kapacitete të përforcuar organizative dhe shkathtësi në përfaqësim dhe rrjetëzim të shoqatave lokale nga komunat e Likovës dhe Staro Nagoriçane;
2. Shkathtësi të zhvilluara sipërmarrëse të fermerëve të rinj dhe burrat dhe gratë të papunë nga komunat e Likovës dhe Staro Nagoriçane;
3. Zgjidhja e inkurajuar e prioriteteve lokale në komunat e Likovës dhe Staro Nagoriçane





Titulli i projektit:

Mësimi gjatë gjithë jetës për zhvillim rural

Organizata:

Shoqata për avancim dhe zhvillim të arsimit për të rritur Rrjeti për Mësim Gjatë Gjithë Jetës Tetovë

Partner:

Shoqata për zhvillim rural Grupi Lokal i Aksionit GLA Skardus, Jegunovcë

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Nxitje të zhvillimit rural me anë të mësimit gjatë gjithë jetës.

Zhvillimi dhe mbështetje e mjedisit të lehtë për zhvillim rural.

Arritja e ndryshimeve sociale në Maqedoninë e Veriut, me anë të realizimit të bashkëpunimit më të mirë mes organizatave qytetare, institucioneve, sektorit afarist dhe vetë qytetarët.

Përforcimi i relacioneve ndër njerëzore dhe ndëretnike me anë të shpërndarjes së më tepër niveleve të komunitetit dhe përmirësimit të cilësisë së jetës.

Qëllimi specifik i projektit:

- Përforcimi i kapaciteteve të palëve të interesuara për përmirësim të gjendjes në mjediset rurale, me anë të përfshirjes së tyre në procesin e krijimit të politikave.
- Njohuri të rritura dhe shkathtësi për përdorimin e masave dhe programeve për zhvillim rural.
- Me anë të rrjetëzimit të aktorëve të ndryshme në komunitet do të shkëmbehen përvoja dhe praktika të mira në fushën dhe në mënyrë që do të sigurojë know-how të nevojshme për nxitjen e zhvillimit rural.

Aktivitete:

1. Aktivitete përgatitore
2. Hulumtim të OJQ-ve që punojnë në rajonin e Pollogut në zhvillim rural, pjesëmarrja e tyre në procesin e vendimit lokal dhe procese të miratimit të vendimeve, bashkëpunimi mes tyre dhe bashkëpunimi me institucionet lokale, sektorin afarist dhe popullatën lokale.
3. Trajnim të bashkëpunimit më të mirë mes OJQ-ve, institucioneve publike, sektorin afarist dhe popullatën për ndikimin më të gjerë në vendimin lokal në fushën e zhvillimit rural.



4. Trajnim për mësimin e gjatë gjithë jetës në kontekst të zhvillimit rural dhe mënyrave inovative për përmirësim të prodhimitarisë bujqësore.
5. Konferenca e fundit – njohuri dhe përvoja të përfituar anë kuadër të projektit dhe rezultatet nga hulumtimet dhe mundësitë për rrjetëzim.

Rezultate:

- -Hulumtim i zbatuar që d të tregojë gjendjen momentale dhe sfidat për zhvillim rural të rajonit të komunës së Jegunovces dhe Tearces.
- Janë edukuar 30 persona – fermerë, përfaqësues të OJQ-ve, sektori afarist dhe institucione publike për përfitimet përdorimit më të lartë të zhvillimit rural.
- Janë rrjetëzuar 55 persona.





Titulli i projektit:

Komunat rurale dhe banorët bashkë ndërtojnë besimin dhe jetën në komunitetin lokal

Organizata:

Koalicioni Rural Kumanovë

Partner:

Shoqata për zhvillim, edukim dhe etikë ekologjike – POLIMAT 13

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Rritje të veprimit të organizatave qytetare si partnerë të barabartë në proceset e miratimit të vendimeve dhe krijimit të politikave në viset rurale

Qëllimi specifik i projektit:

1. Përforsimi i kapacitetit të organizatave qytetare për kyçe aktive në proceset e miratimit të vendimit dhe krijimit të politikave në komunat Bogdanci dhe Krivogashtani;
2. Nxitje të dialogut mes organizatave qytetare dhe vetëqeverisjes lokale në komunat Bogdanci dhe Krivogashtani dhe themelimi i një procesi të bashkëpunimit të vazhdueshëm.

Aktivite:

1. Përcaktimi i shkallës së bashkëpunimit mes vetëqeverisjes lokale, bashkësive lokale dhe organizatave qytetare në komunat Bogdanci dhe Krivogashtani;
2. Përforsimi i kapaciteteve të organizatave qytetare dhe vetëqeverisjes lokale me anë të edukimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe njohurive;
3. Zhvillimi i mekanizmit për bashkëpunim dhe kyçe të organizatave lokale në demokracinë lokale;
4. Organizimi i ngjarjes së fundit për prezantim të rezultateve të arritura.

Rezultate:

1. Organizatat qytetare kanë kuptim më të mirë dhe njohuri të rritura për të drejtat dhe përgjegjësitë për pjesëmarrje të krijimit të politikave dhe miratimit të tyre në nivelin lokal;
2. Mekanizëm i themeluar për bashkëpunim dhe përgjegjësi mes organizatave qytetar edhe pushteteve lokale në Bogdanci dhe Krivogashtani për krijimin e politikave dhe miratimin e vendimeve publike.





Titulli i projektit:

FERMA ORGANIKE – Kohezioni rural për potencial të rritur të turizmit rural dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik

Organizata:

Shoqata Qendra Kreative

RURBANKULT - Strugë

Partner: Shoqata e Bletarëve MATICA 2012 Strugë

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Përforcimi i bashkëpunimit mes organizatave qytetare për të përmirësuar dialogun me palët e interesuara, aktorët e komuniteteve rurale, pushteti lokal/kombëtar dhe bizneset lokale, që janë të përfshirë në proceset e zhvillimit rural në viset rurale.

Qëllimi specifik i projektit:

Projekti ka për qëllim të jep mbështetje zhvillimit të viseve rurale në rajonin e Strugës për përforcim të kapaciteteve të aktorëve në bujqësi, bletari dhe turizëm rural, për veprim të integruar të ndërsjellë në fushën e biznesit.

Aktivitetet:

1. Formimi i lëvizjes për zhvillim rural;
2. Analiza e rastit "Mbledhje dhe analizë të të dhënave relevante për vendet e synuara dhe grupet e synuara, valorizimi i resurseve potenciale për prodhimtari organik dhe turizëm rural";
3. Organizimi i punëtorisë së parë edukative për prodhimtari të ushqimit organik "Ferma Organike";
4. Organizimi i panairit të mjaltit;
5. Organizimi i punëtorisë së dytë edukative;
6. Organizimi i panairit të ushqimit organik dhe tradicional;
7. Post-produksion të materialit të incizuar nga ngjarjet edukative dhe promovuese dhe vendosja në ueb faqen;

Rezultate:

1. Zhvillim i stimuluar i viseve rurale në rajonin e Strugës me anë të përforcimit të kapaciteteve të të aktorëve në bujqësi, bletari dhe turizëm rural, për veprim të integruar të ndërsjellë në fushën e biznesit;
2. Edukim i 30 fermerëve dhe bletarëve për prodhimtari të ushqimit të shëndetshëm organik dhe ngritje



e vetëdijes për mundësinë e veprimit plotësues në ekonomitë e tyre – turizëm alternativ.

3. Janë edukuar 30 pronarë të turizmit rural për zgjerimin e ofertës me anë të prodhimit në shtëpitë e tyre të ushqimit organik dhe përgatitje të specialiteteve nga ushqimi lokal i shëndoshë.
4. Janë lidhur aktorët e komuniteteve rurale për ngjarje publike para institucioneve publike, lokale dhe qeveritare.
5. Promovohet turizmi alternativ rural, turizmi bujqësor dhe prodhimtaria e ushqimit të shëndoshë organik me ngjarje si panaire dhe materiale reklamuese të dokumentuar dhe të vendosur në ueb faqen e Strugës Rurale.
6. Vetëdije e ngritur e të rinjve për mundësitë që ofron turizmi rural.
7. Rritje të bashkëpunimit mes aktorëve të Strugës rurale.



Titulli i projektit:

Krijimi i listës fillestare me produkte tradicionale për vise të qëndrueshme rurale – SILOS

Organizata:

“Shoqata për mbrojtje dhe edukim për ushqim Slow Food Bitola” – Manastir

Partner:

Shoqata për mbrojtjen dhe promovimin e piperit bukovka Presidum Bukovo – Manastir

Shoqata për mbrojtje, promovim dhe edukim të ushqimit Slow Food Osogovo

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Të përmirësohet veprimi i organizatave qytetare në fushën e përfaqësimit dhe lobimit në së paku dy rajone të planifikimit, me anë të ngritjes së kapaciteteve për shkëmbim të njohurive dhe veglave, dhe në lidhje me potencialet dhe nevojat për zhvillim rural të rajonit të veçantë.

Qëllimi specifik i projektit:

1. Të sigurohet bazë për dukshmëri më të gjerë të produkteve lokale tradicionale, me prezantimin e listës së produkteve tradicionale me mundësi për ngritje të mëtutjeshme, dhe prej këtu edhe në rolin e platformës për veprim të ndërsjellë dhe përfshirje të përfaqësuesve të ndryshme të rajoneve të ndryshme.
2. Të nisjet rritje të vetëdijes së organizatave qytetare për dy rajonet dhe për rëndësinë e aktiviteteve të përbashkëta dhe komunikimi me organizatat tjera lokale qytetare, institucione dhe/ose biznese, me anë të zbatimit të fushatës së përbashkët dhe shprehjes së qëndrimeve të përbashkëta me naë të dokumenteve të shkruara.

Aktivite:

1. Krijimi i listës fillestare të produkteve tradicionale;
 - 1.1. Mbledhja e të dhënave për produktet dhe përcaktimi i ekipit të hulumtimit;
 - 1.2. Përpunimi dhe analiza e të dhënave;
 - 1.3. Krijimi i listës dhe shpërndarja përkatëse;



2. Ngritja e vetëdijes me anë të zbatimit të fushatës dhe thirrjes për përfshirje;
 - 2.1. Përpunimi dhe zbatimi i fushatës;
 - 2.2. Thirrje për zgjerim të listës së produkteve tradicionale;
3. Realizimi i takimit dhe formimi i dokumentit me qëndrime.

Rezultate:

1. Janë mapuar më tepër se 70 produkte tradicionale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut prej të cilave 33 gjenden në listë në katalogun botëror në internet “Arka e Shijeve” dhe janë përpiluar përshkrime të hollësishme për së paku 30 produkte, si dhe përshkrime dhe propozime për së paku 50 produkte
2. Organizatat qytetare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit lokal dhe zhvillimit të viseve rurale janë të njohura si aktorë relevant në procesin e përfaqësimit të interesave të prodhuesve të produkteve në vëllim të vogël para miratuesit e vendimeve;
3. Kapacitetet e organizatave lokale qytetare janë të ndërtuar në bazë të zbatimit të hulumtimeve në teren dhe krijim të qëndrimeve për rëndësinë e produkteve tradicionale të nevojshëm për zhvillimin social-ekonomik të rajoneve përkatëse;
4. Institucionet kombëtare, vendimmarrësit dhe organizatat tjera qytetare janë të vetëdijshëm për rëndësinë e listës fillestare me produkte tradicionale dhe roli i tyre në procesin e zyrtarizimit të listës.





Titulli i projektit:

SHËRBIM+ - Përforcimi i organizatave rurale lokale me anë të rritjes së kapaciteteve të tyre për furnizimin e shërbimeve me pagesë për anëtarësinë

Organizata:

Qendra për qëndrueshmëri dhe edukim të avancuar

Partner:

Shoqata për zhvillim të qëndrueshëm PELISTER f.
Rotino

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Organizata lokale rurale të përforcuara në punë
financiare dhe vetë-financim me anë të furnizimit të
shërbimeve me pagesë për anëtarësinë

Qëllimi specifik i projektit:

1. Përmirësim i kapaciteteve të organizatave lokale rurale për punë financiare organizative;
2. Përforcimi i kapaciteteve të organizatave lokale rurale për furnizimin e shërbimeve cilësore për anëtarësinë;
3. Rrjetëzim të organizatave lokale rurale nga Rajoni i Pellagonisë dhe përforcim të bashkëpunimit të ndërsjellë me anë të zbatimit të praktikave më të mira në fushën e furnizimit të shërbimeve cilësore për anëtarësinë.

Aktivite:

- 1.1 Mbështetje administrative për organizatat për regjistrim dhe aktivizim në regjistrin qendror;
- 1.2 Trajnim për punë financiare organizative;
- 1.3 Krijimi i manualit për punë financiare të organizatave;
- 2.1 Analiza e nevojave për shërbime të anëtarëve të organizatave lokale;
- 2.2 Trajnim për furnizimin e shërbimeve cilësore për anëtarësinë;
- 2.3 Krijimi i pakove të shërbimeve të synuara për anëtarësinë;
- 2.4 Pilotimi i shërbimeve ndaj anëtarësisë;
- 3.1 Organizimi i takimeve për rrjetëzim të organizatave lokale rurale të Rajonit të Pellagonisë;
- 3.2 Punëtori për demonstrim të shpërndarjes së praktikave më të mira.



Rezultate:

1. Kapacitete të përforcuar të dy organizatave lokale për punë financiare organizative.
 - 1.1. Së paku dy organizata të regjistruar dhe aktivizuar;
 - 1.2. Të trajnuar së paku 4 persona për punë financiare organizative;
 - 1.3. Dizajnim dhe publikim i manualit për punë financiare të organizatave lokale rurale;
2. Përforcim i kapaciteteve të organizatave lokale rurale për furnizimin e shërbimeve cilësore për anëtarësinë.
 - 2.1. Hartim i analizës për nevojat e shërbimeve të anëtarëve të organizatave lokale;
 - 2.2. Të trajnuar së paku 4 persona për furnizimin e shërbimeve cilësore për anëtarësinë;
 - 2.3. Dizajnim i pakove për shërbime për anëtarësinë;
 - 2.4. Së paku 4 lloje të pakove të shërbimeve të prezantuar dhe furnizuar për anëtarët e organizatave lokale rurale;
3. Rrjetëzim të organizatave lokale rurale nga rajoni i Pellagonisë dhe përforcim të bashkëpunimit me anë të ndarjes së praktikave më të mira në fushën e shërbimeve cilësore për anëtarësinë.
 - 3.1. Të organizuar së paku 5 takime për rrjetëzim të organizatave lokale rurale;
 - 3.2. Të organizuar së paku 2 punëtori për demonstrim të shpërndarjes së praktikave më të mira.





Qasja krahasuese e prioriteteve të zhvillimit rural maqedonas dhe BE

Programe të ngushta ndërsa prioritete të gjera tek zhvillimi rural

Në bazë të rezultateve të hulumtimeve të zbatuara, analiza e përpiluar për identifikim të prioriteteve kryesore dhe çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet rurale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe punëtoritë tematike që janë realizuar në kuadër të projektit «Parlamenti Rural Kombëtar si Zori i Popullatës Rurale», me anë të qasjes krahasuese dhe analizë të dokumenteve kombëtare për zhvillim rural, nga ana e profesorit Sofija Davidova nga universiteti Kent, Mbretëria e Bashkuar, ishin hartuar leksionet e mësuara që kanë të bëjnë me zhvillimin rural në vend.

Sipas kësaj, organizatat qytetare që punojnë në fushën e zhvillimit rural do të mund dhe duhet të luajnë rol kryesor në zhvillimin rural me anë të mobilizimit të komuniteteve rurale që të punojnë bashkë dhe të bëjnë viset rurale tërheqëse për njerëzit të jetojnë dhe të punojnë atje, gjatë kësaj duke siguruar një mjedis për vende pune, rritje ekonomike dhe përdorim të qëndrueshëm të kapitalit natyror dhe themelimit të një shoqërie inkluzive dhe bashkëpunuese.

Kjo më lartë, thotë ajo, nuk është ëndërr e fushave rurale, por realitet, ndonëse është një qëllim afatgjatë i ndërlikuar, që kërkon përpjekje të përbashkëta të gjithë

palëve të interesuara - private dhe publike - dhe zbatim të qëllimeve zhvillimore të vendosur në nivele të ndryshme- kombëtare, rajonale dhe lokale. Organizatat qytetare janë një zë i pavarur, që mund të kontribuojë për dialog social për mënyrën e tejkalimit të sfidave me të cilat përballohen viset rurale në Republikën e Maqedonisë së Veriut; ato janë “brokera” mes popullatës rurale dhe institucioneve publike që merren me zhvillimin e viseve rurale.

Ka një numër të vogël në programet kombëtar edhe ato të BE-së për bujqësi dhe zhvillim rural, që përputhen me prioritetet e ndërlikuar të palëve të interesuara. Nëse programet janë të kufizuar në disa aspekte të zhvillimit rural, aspektet kryesore të bujqësisë, prioritetet e personave që përfshijnë gjitha aspektet e jetës rurale. Duke njohur disa prej mungesave të shtyllës Politika e Përbashkët Bujqësore (CAP) për zhvillim rural (Shtylla 2), BE-ja ka filluar më mirë të koordinojë shpenzimet e Fondit Evropian Bujqësor për Zhvillim Rural (EFARD) me fonde tjera strukturore dhe ato investuese, me qëllim të ndihmohet me zgjerimin e qasjes për çështjet sociale. Përveç kësaj, rregulloret horizontale dhe kalimtare të CAP kanë të bëjnë vetëm me EFARD.





Duke shikuar tre fushat e para prioritare, të theksuar nga ana e OJQ dhe të përmbledhur në raportin e përpiluar nga Aleksandra Martinovska Stojçeva, krahasimi e dëshmon këtë më poshtë:

Prioriteti	Strategjia kombëtare	Programe të BE-së
Përmirësimi i mundësive për punësim dhe vetë-punësim për popullatën e re	Ka një pjesë e arsimit, por vetëm në fushën e bujqësisë, prodhimit të ushqimit dhe bioteknologjisë; shtrirja më e kufizuar sesa nevoja	Sipas përcaktimit është përqendruar në trajnim dhe ri-trajnim të fermerëve, por disa shtetet anëtare të BE-së kanë vendosur të zgjerojnë trajnimin edhe në biznese familjare jashtë fermës
Zhvillimi i turizmit rural	Në disa programe rajonale	Mbështetje për investim; zyra falas të mundshme për këshillim; margjinë e rëndësishme për investime të vogla me anë të LEADER programit
Lehtësimi i qasjes në burime të reja të investimit	Po, disa masa të mbështetjes	Po, instrumente financiare për zhvillim rural; procedurë e ndërlikuar për përdorim – më të ndërlikuar se grantet, andaj nuk përdoren shpesh; Programi për Zhvillim Rural me resurset e dhënë financiare janë për investim në bujqësi dhe përpunim, pastaj nga zhvillimi i fermës dhe biznesit, pastaj pylltarisë; sërish shtrirja më e ngushtë nga nevoja. Mund të përdoren instrumentet financiare për promovim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Tabela tregon që programet kombëtare dhe ato të BE-së kanë një shtrirje relativisht të ngushtë. Duke krahasuar këtë me rezultatet e hulumtimit dhe dokumenteve të shkurta për politika, paraqitet një pasqyrë më e gjerë për nevojat dhe prioritetet.



Këto janë rekomandimet e dhënë nga eksperti Sofija Davidova:

- - Të hartohet strategji kombëtare që është më pak e orientuar sektorëve për në bujqësi, por edhe për zhvillim rural,
- - Krijimi i trupit për koordinim (konsultim) që do të përfaqësojë gjitha ministrinë e përfshirë në zhvillimin rural. Si traditë, në BE dhe në Maqedoninë e Veriut, kompetencat i takojnë Ministrisë së Bujqësisë ose Drejtorisë së Përgjithshme për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Shumë pak prej prioriteteve që i theksojnë OJQ mund të zgjedh vetëm Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit,
- - Të vazhdohet me ngritjen e vetëdijes për problemet me të cilat përballohen popullata rurale.
- - Nxitje të vazhdueshme për angazhim të shoqërisë qytetare në iniciativat e llojit LEADER, nga poshtë lartë, që mund të dizajnohen dhe të zbatohen projekte të vogla për zgjidhjen e problemeve lokale,
- - Mobilizim të resurseve të donatorëve për mbështetje të sipërmarrjes dhe inovacioneve për diversifikim të ekonomisë rurale. Madje edhe në rajonet ku bujqësia luan (si traditë) rol qendror në ekonomi, palët e interesuara japin një mesazh të qartë se bujqësia është në rënie.

- - Sigurimi i arsimit më bashkëkohor interaktive dhe profesionale që mund të përgatit të rinjtë si sipërmarrës në mjediset rurale.
- - Të vazhdohet me trajnimin e OJQ-ve për të ngritur kapacitetet dhe të rritet aftësia e tyre për të kyçur në krijimin e politikave dhe të llobojnë për interesat e komuniteteve rurale.
- - Të përgatitet program për lehtësimin e qasjes në kapital fillestar për MSP në viset rurale.
- - Të diskutohet për zgjidhje pragmatike të problemeve të ndërlukuara për të rinjtë në mjediset rurale që janë të nevojshme për zbutjen e migracionit rural, për shembull, të përcaktohet hapësirë për klube rurale për të rinj, për kulturë ose salla, në të cilat do të mund të zhvillohen shfaqje teatrore, muzikë, orë për gjuhë të huaja, programe për avancimin e shkathtësive; të sigurohen biblioteka mobile, të mbështeten garat lokale sportive.
- - Të vendoset theks në përmirësimin e infrastrukturës fizike, posaçërisht rrugët dhe transporti publik, që mund të ndihmojë në lirin e shtypjes për krijimin e vendeve publike në viset rurale.
- - Teknologji të reja për zbutjen e efekteve të ndryshme klimatike – që përcaktojnë aktivitetet dhe do të paraqesin një pengesë për zhvillimin e mëtutjeshëm dhe mirëqenie të popullsisë.



SHQ CeProSARD në mbrojtje të biodiversitetit me anë të Projektit për drejtim më të mirë me resurset natyrore në parkun nacional «Pelister»

CeProSARD ka vazhduar me aktivitetet për monitorim të mishngrënësve të mëdhenj në Parkun Nacional Pelister, dhe ishte bërë edhe revizion i lokacioneve në të cilat janë vendosur pikat për fotografim në bazë të rezultateve të deritanishme, dhe me qëllim që të jepet më tepër kontribut për cilësinë e të dhënave që fitohen në teren. Në kuadër të projekt gjithashtu ishte hartuar edhe Studim për Shërbime Eko Sistemore të ujërave në PN Pelister, ndërsa për momentin janë në rrjedhë përgatitje për fillimin e aktiviteteve për pastrim dhe shënim të dy korsive për biçikletë në territorin e parkut.

Ky projekt është pjesë e Programit për Përmirësim të Drejtimit me Rajone të Mbrojtura, financuar nga Bashkimi Evropian, dhe zbaton UNDP, me mbështetjen e Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lidhje për në ueb faqen: <https://www.facebook.com/nppmk/posts/1102046673327223>





Projekti Ndërtimi i kapaciteteve për zhvillim të qëndrueshëm të Grupeve Lokale të Veprimit - GLA në proceset e integritimit në BE - Bildlag projekti

Në periudhën prej mars deri qershor të këtij viti, ekipi i projektit BILDLAG ka punuar në regjistrimin e GLA-së të sapoformuar në rajonin e Pollogut dhe hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Në fillim të muajit mars, ekipi i projektit ka organizuar takim konsultues me drejtorin e Qendrës për Zhvillim të Rajonit të Pollogut të Planifikimit, z. Fatmir Saiti, në të cilin ishte bërë një prezantim i shpejtë i aktiviteteve lidhur me regjistrimin dhe formimin e GLA-së së re në rajonin e Pollogut mes komunave të Tetovës, Zhelinës dhe komunës së Bervenicës. Gjatë muajve të ardhshme, prill dhe maj, ishte krijuar Strategjia GLA-Pollog e porsaformuar dhe plani i veprimit nga ana e ekspertëve të angazhuar, prej të cilave ishte zgjedhur një aktivitet që ishte zbatuar pas përfundimit të projektit BILDLAG, me qëllim të ndihmës për nisjen e punës dhe funksionimin të GLA-së. Në fillim të muajit maj ishte zhvilluar një punëtori me qëllim të prezantimit të strategjisë së hartuar në hapësirat e Qendrës për Zhvillim të Rajonit të Pollogut, në të cilat kanë marrë pjesë anëtar të kuvendit themelues të GLA-së, si dhe përfaqësues të entiteteve të synuar të rajonit.



Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

Lidhje për në ueb faqen:

http://ceprosard.org.mk/MK/Aktuelnosti_info.aspx?cid=445

http://ceprosard.org.mk/MK/Aktuelnosti_info.aspx?cid=471





Zhvillimi i turizmit rural FRET-STIC

Në kuadër të projektit “Nxitja e Turizmit Rural dhe Ekologjik me anë të Qendrave të Mençura Turistike (FRET-STIC)”, gjatë periudhës së fundit janë intensifikuar aktivitetet lidhur me themelimin e objekteve të qendrave turistike informative (STIC). Në këtë drejtim, filloi ndërtimi i tyre në Maqedoni dhe në Kosovë dhe pritet që gjatë muajve të verës të vendosen në vende tërheqëse në Tetovë dhe Prizren. Ishte angazhuar kompani për softuerë për të zhvilluar një platformë interaktive, që nga kërkimet e turistëve do të mbledh dhe do të analizojë të dhëna për preferencat e tyre dhe do të mundësojë përmirësim dhe mbindërtime. Gjithashtu, me këtë platformë do të bëhet edhe rrjetëzim të qendrave aktuale dhe të reja informative për turistë nëpër rajonin e Malit Sharr.

Ekipi i projektit gjithashtu vazhdon me takimet e rregullta konsultative me aktorë të rajonit. Takimi i dytë konsultativ ishte organizuar më 19-20 mars 2019 në Prevallë (Kosovë), bashkë me takimin e dytë të Komitetit Udhëzues të projektit. Në takimin kanë marrë pjesë më tepër se 30 pjesëmarrës që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për zbatimin e mëtutjeshëm të projektit.

Ky projekt, me kohëzgjatje prej 24 muajve, CeProSARD e zbaton në bashkëpunim me Komunën e Tetovë dhe RDA South të Kosovës, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian me anë të programit për bashkëpunim ndërkuftar mes Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës.



30 evergreen trees for the Municipality of Butel on the Ecology Day 25 March

Në shënimin e Ditës së Ekologjisë, në Komunën e Butelit, SHQ CeProSARD pjesëmarrësve të ngjarjes ju ka dhuruar fidanë gjethe mbajtës.

Fidanin e parë SHQ CeProSARD ka dhuruar kryetarin të komunës së Butelit, z. Velimir Smilevski. Fidanët ishin mbjellë në oborrin e komunës, oborret e shkollave dhe shtëpitë e nxënësve të komunës së Butelit.

Lidhje për në ueb faqen:

<https://24info.mk/%d0%b4%d0%b5%d0%bd%d0%be%d0%b2%d0%b8-%d0%bd%d0%b0-%d0%b5%d0%ba%d0%be%d0%bb%d0%be%d0%b3%d0%b8%d1%98%d0%b0%d1%82%d0%b0-%d0%b2%d0%be-%d0%be%d0%bf-%d1%88%d1%82%d0%b8%d0%bd%d0%b0-%d0%b1%d1%83%d1%82%d0%b5/>





Dhuro për shtëpi të sigurt dhe rrethinë të sigurt

Me anë të projektit “Dhuro për shtëpi të sigurt dhe rrethinë të sigurt», shoqata e qytetarëve EKOVIDA ka pasur për qëllim të edukojë qytetarët për mënyrën e mbrojtjes nga rrezatimi elektromagnetik. Ky projekt ishte mbështetur me anë të projektit “Ndryshime për Qëndrueshmëri” financiar nga BE-ja, ndërsa zbatuar nga “Konekt”, fondacioni “Apolonia» Dhe Qendra për Politikë Tatimore.


Në kuadër të projektit ishte zbatuar edhe e ashtuquajtura EKOPATRULLA, si dhe aksioni për donacione me anë të cilave ishin siguruar mjete financiare për prokurimin e 4 instrumenteve për matjen e rrezatimit elektromagnetik.

Me aparaturën e sofistikuar, EKOVIDA ka bërë një analizë spektrale, gjegjësisht ka përcaktuar frekuencën dhe fuqinë e rrezatimit elektromagnetik në shtëpitë e klientëve, që vijnë nga aparatet elektrike, ruterëve, laptopëve, telefonave celularë, transmetuesve, etj. Përveç faktit që EKOVIDA tregon për ekspozimin e rrezatimit, gjithashtu jep edhe këshillime për përdorimin e sigurt të aparateve.

Kujdes me laptopin

EKOPATRULLA ka matur vlera të rritura të fluksit magnetik mbi 20 mikrotlesa të 50Hz frekuencë tek laptopët, për të cilën është theksuar që të përdoret një distancë e sigurt të laptopit nga trupi dhe të ketë kujdes posaçërisht për të rinjtë, sepse rrezatimi elektromagnetik në këtë pozitë është e dëmshme për organet riprodhuese tek meshkujt dhe femrat.

Ekipi i projektit të EKOVIDA konsideron që një prej arsyeve për përqindjen e rritur të problemeve me sterilitetin tek çiftet e reja martesore është përdorimi i gabuar i laptopit.



Mbajtja e gabuar e laptopit në prehër, pamje e shpeshtë tek të rinjtë

Rekomandim për përdorim të laptopit është përdorimi i tavolinës ose jastëkut mbi 10 cm dhe me atë zvogëlohet rrezatimi elektromagnetik në vlera të sigurt.



Mbajtja e drejtë e laptopit në prehër





Rekomandimet nga EKOVIDA për uljen e ndotjes nga **rrezatimi elektromagnetik pa jone** është një prej gjërave më të rëndësishme që mund të bëni në shtëpinë tuaj, për të përmirësuar shëndetin e familjes suaj.

➤ **Përdorni në mënyrë të sigurt ruterin:**

- ruterin fikeni gjatë natës
- Laptopin dhe aparatet tjera pa tel - lidhni me kabllot e rrjetit në ruter, mos e përdorni opsionin Wi-Fi.
- Mos e ndani dhe shpesh ndryshoni fjalëkalimin e ruterit, do të mbroheni ju dhe fqinjët nga rrezatimi i tepërt elektromagnetik.

➤ **Përdorni në mënyrë të sigurt telefonin tuaj të mençur:**

- Mos e mbani telefonin tuaj në xhep, nëse nuk është në mënyrën «Avion».
- Mos e vendosni telefonin në afërsi të veshit tuaj, përdorni altoparlant ose dëgjuese.
- Mos përdorni telefonin kur jeni në veturë, lift ose bodrum – niveli i rrezatimit rritet.
- Mos përdorni telefonin deri sa jeni në mal ose ku ka sinjal të dobët – niveli i rrezatimit rritet. Nëse e keni patjetër të përdorni telefon celular, bëjeni atë fillimisht me mesazhe me tekst dhe raste urgjente.

➤ **Përdorni laptop kompjuterin tuaj në mënyrë të mençur:**

- Më së miri është të përdorni laptop që është në energji të baterisë (pa mbushje/të kyçur).
- Përdorni tastierë të jashtme me tel dhe mi që të zvogëloni ekspozimin në FEM mbi trupin tuaj.
- Asnjëherë mos vendosni laptopin tuaj në prehër/trup. Mund të përdorni jastëk mes laptopit dhe trupit tuaj.
- Përdorni kabllot e rrjetit për internet (në vend të Wi-Fi). Asnjëherë mos transferoni video ose muzikë duke përdorur Wi-Fi.



➤ **Përdorni televizorin tuaj të mençur në mënyrë të urtë:**

- Përdorni vetëm kabllot për rrjetin e internetit (në vend të Wi-Fi). Duke përdorur Wi-Fi – niveli i rrezatimit rritet tek ruteri dhe tek televizori.
- Krijoni vend të veçantë për fjetje - një prej hapave më të dobishme që mund të ndërmerri është të zvogëlohet ekspozimi mbi SEM gjatë fjetjes:
- Shkyçni gjithçka që është në dhomën tuaj të gjumit gjatë natës.
- Ruani dhe mbani telefonat celular dhe aparateve tjera elektronike jashtë dhomës tuaj të gjumit. Përdorni alarm të thjeshtë me bateri.
- Krevati të jetë në distancë minimale prej 20 cm nga prizat ose kyçëseve.



Ndërtohet Qendër Informativ për lokalitetin Kuklica



Si pjesë e rrjetit kombëtar të rajoneve të mbrojtura në Rajonin Verilindor të komunës së Kratovës, gjendet edhe lokaliteti Kuklica, një prej formave më përfaqësuese gjeo-morfologjike të natyrës në Republikën e Maqedonisë. Lokaliteti paraqet një kompleks i rrallë natyror me gjeo-forma të ruajtura dhe është një përmendore individuale gjeo-morfologjike e natyrës me rëndësi të jashtëzakonshme shkencore, arsimore, turistike dhe kulturore.

Në përputhje me Ligjin për Mbrojtje të Natyrës (Gazeta Zyrtare e RM-së, Nr. 67/2004, 14/2006 dhe 84/2007) lokaliteti Kuklica është shpallur në vitin 2007 si rajoni i mbrojtur prej kategorisë III - përmendore e natyrës.

Ndonëse lokaliteti Kuklica është shpallur rajoni i mbrojtur nga ana e organit më të lartë të pushtetit në Republikën e Maqedonisë, sërish, në lokalitetin duhet të mbrohet natyra dhe vlerat natyrore, të përmirësohen

kapacitetet e drejtimit të qëndrueshëm dhe promovimit të rajonit të mbrojtur në mënyrë profesionale dhe të qëndrueshëm.

Shoqata për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor, Përmendoreve Kulturore-Historike dhe Shëndetit të Njeriut «IZVOR» Kratovë drejton me lokalitetin Kuklica në bazë të një marrëveshje të firmosur me qeverisjen lokale të Komunës së Kratovës.

Në kuadër të projektit "Përmirësimi të Drejtimit me Rajonet e Mbrojtura", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP në bashkëpunim me MMJPH, shoqata "IZVOR" ka realizuar aktivitete të fokusuara në rregullimin infrastrukturor dhe parter, hulumtim të gjendjes së llojlojshmërisë gjeologjike dhe komponentit social dhe ekonomik, ngritje të vetëdijes të popullatës lokale me anë të zhvillimit të punëtorive për përputhje me standardet e BE-së në fushën e turizmit rural.





Me realizimin e këtij projekti është kontribuar për plotësimin e dispozitave në përputhje me Ligjin për Shpallje të Lokalitetit Kuklica për Përmendore të Natyrës, që kanë të bëjnë me nevojën e zbatimit të aktiviteteve dhe çështjeve me interes për mbrojtje të vlerave natyrore që janë me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe drejtim të qëndrueshëm të rajonit të mbrojtjes.

Përveç aktiviteteve tjera të realizuara në këtë projekt është ndërtuar edhe objekti Qendra Informative-Edukative.

Më 08.06.2019 Qendra Informative ishte hapur zyrtarisht nga ana e Ambasadorit të Delegacionit të bashkimit Evropian, z. Samuel Zhbogar dhe përfaqësuesi i përhershëm i Programit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) Narine Sahakjan në prani të kreut të komunës së Kratovës, Dr. Ljupço Bojaxhiev, përfaqësues të UNDP-së, Ministrisë së Mjedisit Jetësor, institucione dhe medie.

Qendra Informative e re është dizajnuar dhe krijuar në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian në kuadër të veçorive kryesore të lokalitetit Kuklica dhe do të kontribuojë për zhvillimin dhe promovimit e turizmit si dhe mundësi për punësim.

Objekti përfshin galeri me informacione për përmendoren e natyrës Kuklica, pikë për shitje të gjërave për kujtim dhe materialet promovuese si dhe hapësirë për zhvillimin e ngjarjeve shkencore dhe tjera publike.





Aktivite dhe arritje të Qendrës Rajonale për Përfaqësim – Dellçevë

1. Qendra Rajonale për Përfaqësim ka fituar çmimin për më të mirët në sektorin joqeveritar për vitin 2018 në Maqedoninë Lindore si njohe të gjitha projekteve të realizuara, përfshirë edhe disa nga viti i kaluar. Çmimin ka dhënë Aktivi i Shoqatës së Gazetarëve të rajonit lindor në kuadër të manifestimit tradicional “Më e mira nga Lindja». Ngjarja ishte zhvilluar në prill në amfiteatrin e universitetit Ndërkombëtar Sllavik “Gavrillo Romanoviç Derzhavin” në Sveti Nikollë, ndërsa ishin shpërblyer 16 persona, firma dhe organizata joqeveritare, që gjatë vitit 2018 kanë lënë shenjë në zhvillimin dhe kanë promovuar rajonin lindor.
2. Një përfaqësues i QRP në janar ishte në vizitë studimore të organizatave joqeveritare dhe institucioneve në Gjermani për të njoftuar me funksionimin e tyre dhe përvojat si pjesë e Bashkimit Evropian. Vizita e shtatë organizatave në gjithsej tre qytete të Gjermanisë ishte pjesë e programit grante të vogla “Aktivizo” të Preda Plus që QRP-ja me sukses ka zbatuar projektin e miratimit të Strategjisë për Bashkëpunim të Komunës së Dellçevës me sektorin joqeveritar.



3. Përfaqësues të QRP në maj ishin pjesë e ekipit prej nëntë anëtarë nga Maqedonia që kanë marrë pjesë në Lider Fest 2019, Zhatec, Republika e Çekisë. Qëllimi i ngjarjes ishte promovimi i LEADERE masës në rajon me anë të aktiviteteve dhe masave që janë pjesë e GLA (anëtarët e QRP-së janë anëtarë të Grupit Lokal të Aksionit Malesh-Pijanec) dhe LEADER në Bashkimin Evropian, që është qasje kryesore për qasje të organizatave dhe zhvillim të viseve rurale në vendet anëtare të BE-së, përfshirë edhe kandidatët për anëtarësim. Gjithashtu, QRP ka organizuar edhe Lider Fest të parë në Maqedoni në vitin 2015 që ishte zhvilluar në Dellçevë.



4. Gjatë periudhës aktuale QRP zbaton një projekt nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë me titullin «Qendra edukative për siguri dhe shëndet në punë në Rajonin Lindor të Planifikimit» me të cilin janë zbatuar tre punëtori për vetëvlerësim, punë financiare dhe drejtim me resurse njerëzore për anëtarët themelues të saj. Qëllimi i projektit është që në periudhën vijuese të formohet një rrjet i organizatave qytetare që një pjesë të punës do të orientojnë në promovimin dhe përpjekjet në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë që do të rregullohet me memorandum për themelimin e rrjetit dhe planit të veprimit në bazë të së cilës do të zhvillohet puna e rrjetit. Faza e fundit e projektit do të zhvillohet paralelisht me dy të parat dhe kanë të bëjnë me themelimin e qendrës për SShP për rajonin lindor të planifikimit që në një vend do të koordinojë gjitha palët e interesuara që në mënyrë të drejtë ose jo janë të përfshirë në aktivitete për siguri dhe shëndet në punë në rajonin lindor të Maqedonisë.





Zbatim i suksesshëm dhe vazhdim i projektit Natyra Paralajmëron #budniliste

Projekti: «Natyra Paralajmëron - aktivitete për komunitetin për mbrojtje të biodiversitetin» që zbaton shoqata - Qendra Ndërkombëtare për Art dhe Zhvillim të Qëndrueshëm ART POINT – GUMNO, nga shtatori 018 me mbështetje të fondit për klimë nga Ministria e Punës së Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë, dhe në bashkëpunim me komunën e Demir Hisar dhe NPK Komunalec, Demir Hisar, zyrtarisht përfundoi më 22 prill.

Në Ditën e Planetit Tokë, në Shtëpinë e Kulturës “IL-INDEN” në Demir Hisar, mbi 220 fëmijë të vegjël kanë ndjekur ngjarjen premierë të shfaqjes: „NATYRË ose MBETURINË”. Sipas tekstit të librave për ngjyrë të publikuar në kuadër të projektit, skenarin e ka përgatitur aktorja e re maqedonase me reputacion ndërkombëtar – Natasha Petroviq, që njëherë edhe ka luajtur rolin e zogut Sojka. Përveç asaj, në shfaqjen kanë marrë pjesë edhe Nenad Mitevski (fëmija Stefan) dhe Bojan Kirkovski (xhaxhi Krimb). Dizajnin dhe kostumografinë janë të Voskresija Andreevska nga “Art Point – Gumno”. Kostumet janë bërë nga materiale të ricikluara!

Personat përgjegjës për zbatimin, madje edhe donatorët, janë më shumë se të kënaqur nga rezultatet e arritur gjatë zbatimit të këtij projekti: me sukses është senzibilizuar gjithë komuniteti për çështjet e mjedisit jetësor dhe problemin me mbeturinat; është themeluar sistem funksional për selektim, mbledhje dhe riciklim të PET ambalazheve; janë shënuar kontejnerë për selektim të mbeturinave nga qelqi; në më tepër se 10 vende me sukses zbatohet kompostimi i mbeturinave organike; më të rinjtë i dinë përfitimet nga prodhimtaria në kopshtet personale dhe përdorimi i kompostit dhe farat autoktone...; përforcohet bashkëpunimi dhe rrjetëzimi mes organizata OJQ – Instituti për Studime të Komunikimeve, Slow Food Vodno, Eko Svest, Nebo, etj.





1. Realizohet aksioni i parë i madh për pastrim të lumenjve në Demir Hisar

Në pritje të mbështetjes për fazën e dytë të projektit “Natyra Paralajmëron”, shoqata - Qendra Ndërkombëtare për Art dhe Zhvillim të Qëndrueshëm ART POINT - GUMNO vazhdon me iniciativa për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përforsimin e vetëdijes së popullatës lokale. Më 29 qershor, në bashkëpunim me Institutin për Studime të Komunikimeve, si pjesë e fushatës për mjedis më të mirë jetësor «Mos Injoro! Reago!» ishte organizuar pastrim i lumenjve në f. Silloeshticë. Aksionin e ka mbështetur edhe komuna dhe ndërmarrje publike komunale nga Demir Hisari dhe një numër i madh i vullnetarëve nga fshati, individë dhe përfaqësues të OJQ sektorit nga Demir Hisari, Shkupi dhe vende tjera, me të cilëve edhe përfaqësues të iniciativës qytetare “Mos u bëj bërlllok” nga Manastiri («Pastrojmë me ...»). Për pothuaj më pak se 3 orë, nga korita e Bella Reka ishin mbledhur më shumë se 3 tonelata mbeturina.



2. Janë vendosur info-tabelat nga projekti “Shtëpia e Përherhshme e Petre M. Andreevski”

Projekti është mbështetur nga Komuna e Demir Hisarit, dhe këtë vit, shoqata Qendra Ndërkombëtare për Art dhe Zhvillim të Qëndrueshëm ART POINT – GUMNO do të vazhdojë me rregullimin infrastrukturor të hapësirës rreth varrit të Petre M. Andreevski.





Shoqata e prodhuese të ushqimit organik Kavadar

Nga 21 janari 2019, SHPUO "Biovita" ka filluar me zbatimin e projektit "Inkubator për Bletari Organike – VITAÇ" që zbatohet në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), që është financuar nga Bashkimi Evropian (BE), ndërsa zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është parandalimi i imigrimit dhe gjallërimi i fshatrave rurale me rritje të numrit të grave dhe personave të rinj që kanë theme-luar koshare të reja me blerë në viset e populluara rurale, ndërsa qëllimet specifike të projektit janë krijimi i mundësisë për përforsim ekonomik të të rinjve dhe grave, që vijnë nga viset rurale me anë të bletarisë organike dhe ngritje të vetëdijes publike për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe edukim të fermerëve për prodhimtarinë organike.

Ishte siguruar mundësi për edukimin e vazhdueshëm për bletari organike në inkubatorin «VITAÇ» dhe ishin trajnuar 11 persona (bletarë meshkuj dhe ferma) dhe kanë fituar certifikatë për trajnim për bletari organike.



Në periudhën prej mars-prill SHPUO "Biovita" në bashkëpunim me klubin kinologjik "Qeni i Maqedonas i Bariut - Karaman" 4 ekonomive bujqësore nga komuna e Kavadarit ju ka dhënë nga një qen të racës karamani nga kompania MOK «Karaman». Një prej tyre është fermë organike për dhen, e dyta është fermë organike bujqësore, në të cilën kultivohen raca autoktone të kafshëve dhe bimëve, ferma e tretë dhe e katërt janë ferma për dhen në proces të certifikimit/ndryshimit nga prodhimtaria konvencionale në atë organike.





Në muajin maj SHPUO "Biovita" ka realizuar vizitën në "Shtëpi të Vogël për Fëmije në Rrezik Social" nga Kavadari, për të filluar bashkëpunim, pas së cilës ka vijuar nënshkrimi i Memorandumit për Bashkëpunim mes shoqatës dhe Entit Publik - Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale - Kavadar. Në këtë mënyrë ju është mundësuar që banorëve të «Shtëpisë së Vogël të Grupit» të mund të mund realizojnë aktivitete në natyrë me vizita të ekonomive bujqësore që merren me prodhimtari organike. Në kohën e njëjtë fitohet mundësi dhe kushte për ngritjen e tyre në nivelin edukativ.

Në muajin qershor, SHPUO "Biovita" me Shoqatën e Shkrimtarëve "Tikveshki Cvetovi" nga Kavadari kanë realizuar aktivitet vullnetar "Pasdite me Bimët" në rrethin e f. Garnikovë.



Në muajin e njëjtë ishte organizuar edhe Poetry Slam i parë rural në luginën Vitaçevë - Kavadar në një parcelë të vogël të mbjellë me lavandë organike. Këtë ngjarje në mënyrë vullnetare kanë organizuar: SHPUO "Biovita", SHQ "Teatarska Rabotilnica" – Prilep, Shoqata për Kulturë Alternative "Alter Centar" – Kavadar, Enti Shtetëror Shtëpia Publike «Ivan Mazov - Klime» - Kavadar dhe në iniciativë të Poetry Slam Macedonia.





“Zllaten Grozd” në Mellnik, R. e Bullgarisë



Në organizim të Shoqatës “Horti Eko», Strumicë, dhe në ftesë të organizatave bujqësore dhe shoqatave nga Bullgaria, fermerët e rajonit të Strumicës, më 9 shkurt 2019, kanë marrë pjesë në manifestimin e nëntë me rrallë «Zllaten Grozd» në Mellnik, R. e Bullgarisë. Në këtë destinacion atraktiv të verës në Bullgari nikoqirët ju kanë ofruar të ftuarve të tyre të shijojnë verë të bukur të kuqe të prodhuar nga verëritë më të mira të rajonit. Të pranishmit në manifestimin kanë pasur mundësi të degustojnë verëra nga lloje vendore – të prodhuar me receta që përdoren për qindra vite, siç është vera e Mellnikut e njohur që bëhet nga lloji «rrushi i gjerë i Mellnikut». Festivali “Zllaten Grozd” në Mellnik është bërë një kryeqendër e vërtetë e verës së mirë. Festa e ka gjallëruar qytetin në të cilin kanë arritur qindra mysafirë nga vendi dhe jashtë vendit, me dëshirën për të provuar eliksirin e kuq dhe të kënaqen në magjinë e piramidave të rërës. Qëllimi i këtij festivali është afirmimi i verës i prodhim kombëtar i verës dhe zhvillimit të rajonit si destinacion për turizëm të verës si dhe promovim të traditës dhe gjallërimit dhe avancimit të jetës rurale, me anë të kujdesit të zakoneve tradicionale të harruara.

Në kuadër të vizitës së manifestimit të Zllaten Grozd në Mellnik fermerët kanë mundësi të njoftohen me procesin e prodhimit të verës me cilësi të lartë të bërë sipas standardeve më të larta evropiane dhe praktike si dhe të degustojnë verëra të larta të llojeve të ndryshme të bodrumit të verës “Villa Mellnik”. Bëhet fjalë për një verëri bashkëkohore familjare në afërsi të Mellnik, prodhues i erës nga lloje lokale dhe të huaja me karakter të rëndësishëm të bluarjes. Verëria posedon 300 dekar të hardhive personale me kapacitet vjetor të përpunimit prej rreth 250 tonelata rrush. E ndërtuar në tre nivele, ndërsa procesi i verës është organizuar në mënyrë që rrjedhja e verës lëviz nëpër tre nivelet e verës me anë të fuqisë së gravitacionit. Përveç që është kursim i energjisë, kjo metodë unike gjithashtu është e butë për rrushin dhe verën që ato të ruajnë sa më tepër strukturën natyrore. Verëria është e pajisur me pajisje të teknologjisë së lartë nga kompani udhëheqëse bullgare dhe të huaja. Pjekja e verës më cilësore zhvillohet në tunelet e gropuar në kodrat, me çfarë sigurohet temperaturë dhe lagështi natyrore.





Panairi ndërkombëtar në Selanik

Një grup prej 55 fermerëve në organizim të shoqatës "Horti Eko" nga Strumica, më 2 shkurt 2019, kanë marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar në Selanik, Greqi, në të cilën kanë pasur mundësinë që të njoftohen me teknologji të reja dhe ishin prezantuar edhe arritjet më të reja botërore. Qëllimi i vizitës së panairit ishte të shkëmbehen përvojat dhe idetë, të shikohet zbatimi praktik i teknika të reja dhe teknologjive në bujqësi dhe nxitje dhe zbatim tek ne, realizimi i takimeve afariste, kopjim i mënyra inovative të prodhimitarisë.

Në këtë mënyrë nxitet planifikimi i përbashkët dhe marrja e vendimeve për zbatim të teknologjive të avancuara me qëllim të uljes së shpenzimeve të prodhimitarisë dhe rritje të rentabilitetit të fermerëve maqedonas.

Panairi ndërkombëtar bujqësor AGRA 2019 në Plovdiv, R. e Bullgarisë

Një grup i fermerëve, sërish me mbështetjen e shoqatës "Horti Eko" e kanë vizituar Panairin ndërkombëtar bujqësor AGRA 2019 në Plovdiv, R. e Bullgarisë. Në kuadër të panairit që është zhvilluar për herën e 28-të, ishin prezantuar arritjet më të reja të botës në pjesën e mekanizimit, pajisje dhe repromaterialeve. Në kuadër të panairit për herën e 7-të m rend, fermerët kanë pasur mundësinë të vizitojnë edhe panairin për prodhimitari organike BIO AGRA 2019.

Paralelisht me Agra 2019 ishte zhvilluar edhe panairi ndërkombëtar për vreshtari dhe verëri "VINARIA", panairi ndërkombëtar për ushqim, pije, paketim, makina dhe teknologji "FUDTEKS", panairi për ushqim të lartë cilësor italian dhe verë "Shijet e Italisë".





Panairi ndërkombëtar për pemë dhe perime FRESKON 2019 në Selanik, R. e Greqisë

Panairi ndërkombëtar për pemë dhe perime FRESKON është edhe një panair në të cilin kanë pasur mundësi të vizitojnë të gjithë aktorët e interesuar, me ndihmën e shoqatës Horti Eko. FRESKON paraqet manifestimi më i madh i panairit për pemë dhe perime që zhvillohet në Ballkan dhe Evropën Juglindore. Manifestimi ishte organizuar për herën e pestë dhe ishte pika qendrore e sektorit, duke shërbyer si vend për takime të prodhuese, grupeve ndërkombëtare për shitje me pakicë, si dhe transportues të vendit dhe të huaj të pemëve dhe perimeve të freskëta. Në kohën e njëjtë, në ekspozitën ishin ekspozues nikoqir dhe ndërkombëtar që janë aktiv në sektorin dhe paraqesin pika më bashkëkohore të fokusit të tregut me pemë dhe perime të freskëta, logjistikë, makina dhe materiale për paketim, etj.



Me aksion të ri të gjelbër deri në mjedis më të shëndoshë jetësor!

“Me aksion të ri të gjelbër deri në mjedis më të shëndoshë jetësor!” është motoja e aksionit që kanë zbatuar nxënësit e shkollës së mesme “Dimitar Vllahov” nga Strumica, të drejtimit bujqësi, në bashkëpunim me shoqatën “Horti Eko”.

Aksioni i gjelbër përbëhej nga mbjellja e fidanëve gjethembajtëse dhe gjetherënëse në shkollë dhe konviktin. Qëllim i aksionit ishte krijimi i pjesëve të gjelbër dhe mbjellja e sipërfaqeve publike, por edhe për të dërguar mesazh tek shokët e shkollës dhe të rinjtë për avancimin e mjedisit jetësor.

Ishin mbjellë gjithsej 36 fidanë. Qëllimi i nxënësve të shkollës së mesme është të nxisin të gjithë aktorët e komunës për kopjim dhe zbatim të idesë, për të themeluar fushatë afatgjate për pastrimin e ajrit dhe infrastrukturës së Komunës.

Aksioni në SHMK Dimitar Vllahov ishte realizuar si pjesë e projektit “Të rinjtë nga mjediset rurale për integrim të Maqedonisë në BE” që është duke u zbatuar nga CNVP dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë.





Koalicioni Rural

Më 28 janar 2019, Koalicioni Rural ka përfunduar projektin me titullin: "Perspektiva gjinore dhe organizatat lokale qytetare të përfshirë në politikat lokale për bujqësi dhe zhvillim rural". Rezultatet e projektit ishin prezantuar në ngjarjen përfundimtare të organizuar në fshatin Pçinja, Kumanovë, në të cilën pjesëmarrësit nga ngjarja në Tetovë dhe Kumanovë (dy rajonet në të cilat ishte realizuar projekti) ishin dëshmitarë të arritjeve më poshtë:

- janë zhvilluar 3 trajnime me përfaqësuesit e organizatave lokale qytetare të rajonit të Pollogut dhe Verilindor që duhet të përforcojnë qëndrueshmërinë financiare të organizatave qytetare në nivelin lokal, të mundësojnë monitorimin praktik të proceseve të krijimit dhe zbatimit të politikave publike dhe vendimeve që i miratojnë vetëqeverisjet lokale, si dhe të kujdesen për konceptin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor;
- Janë formuar dy platforma aktive në secilin prej rajoneve të përbërë nga gjitha aktorët lokal në kuadër të një komune (organizata qytetare, sektorin afarist, institucione publike, etj.) që kanë për qëllim në mënyrë aktive të monitorojnë politikat publike dhe të reagojnë në çdo vend që ka hapësirë për atë, por edhe të ndër marrin aktivitete për imponimin e aspekteve gjinore në çdo politike lokale dhe aktivitete;
- Ishte zbatuar fushatë informative për thirrjen aktuale për IPARD2 dhe me qëllim që të parashtrohen më shumë aplikacione dhe përdorimi në nivelin lokal të rritet posaçërisht nga ana e grave dhe të rinjve.

Projekti ishte mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni.

Më vonë, në shkurt, shoqata Koalicioni Rural ka finalizuar projektin "Komuniteti lokal dhe komuna bashkërisht krijojnë strategjinë për zhvillim ekonomik", gjatë së cilës në komunën Staro Nagoriçane ishte prezantuar versioni i fundit i strategjisë për zhvillim lokal ekonomik të komunës që bashkërisht kanë punuar komuna, popullata lokale, aktorët përkatës lokal dhe Koalicioni Lokal. Ky proces inkluziv në prani të vetë kryetares së komunës, z-nja Zhaklina Jovanovska, në gjitha fazat e procesit, ka dëshmuar që përfshirja dhe bashkëpunimi i drejtë i gjithë aktorëve lokal gjatë hartimit, por edhe zbatimit të dokumenteve cilësore strategjike janë në





interes për komunitetin. Projekti ishte nën-grant në kuadër të projektit "Organizatrat qytetare në shërbim të demokracisë lokale", zbatuar nga ALDA Shkup, Lëvizja Evropiane Maqedoni dhe Shoqata e Punëtorëve Financiar të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ndërmarrjet publike me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian me anë të IPA 2 instrumentit.

Më 5 mars, Koalicioni Rural ka zhvilluar seancën vjetore të Kuvendit të shoqatës. Organizimi i këtij kuvendi ishte mbështetur financiarisht nga MCMS në kuadër të programit Civica Mobilitas. Seanca vjetore e Kuvendit njëherë ishte edhe seancë zgjedhore, gjatë së cilës delegatët e Kuvendit kanë zgjedhur përfaqësues të trupave drejtues dhe mbikëqyrës që gjatë 2 viteve të ardhshme do të bëjnë përpjekje për të avancuar punën e organizatës. Gjithashtu, gjatë Kuvendit ishin miratuar edhe dokumentet e hartuar paraprakisht për organizim dhe punë të strukturës së brendshme të Koalicionit, dhe ishin shpallur tre gratë më të suksesshme fermerë, anëtare të Koalicionit për vitin 2018:

- Zhivka Gjurčinovska, grua fermer, që vije nga fshati i Gostivarit, Tumçevishte, dhe shumë investon në diversifikimin e prodhimit të bujqësore dhe është një grua që shërben si shembull në fshatin dhe rajonin.
- Vesna Janevska, mjeshtër i vërtetë për specialitete tradicionale, paraqet një shembull pozitiv për gjithë Rosomanin, por edhe më gjerë, është anëtare e grupacionit Slow Food, prodhuese e palodhshme dhe propaganduese e prodhimit të tradicionale dhe është shumë e njohur për prodhimtarinë e «reçelevë» unike të cilat dëshiron të bëjë markë si prodhimtari lokal të mbrojtura. Ju ndihmon të afërmeve, fqinjëve, bashkëfshatarëve në mirëmbajtjen e prodhimit të bujqësore, dhe çdoherë mund të gjeni në tregun më të njohur në Rosoman.
- Valentina Trpeska, fermer nga fshati Sllavej, Krivogashtani, një prej grave të para përdoruese të mjeteve nga IPARD programi, punon ngushtë me anëtarët tjerë të familjes, dhe ajo vetë është bartës i ekonomisë familjare bujqësore. Investon në rritjen dhe zhvillimin personal, edukim të fëmijëve të saj, e hapur për zbatimin e teknologjive dhe veglave në prodhimtarinë bujqësore. Kryesisht kultivon duhan dhe grurë.



Koalicioni Rural, në partneritet me Këshillin Kombëtar për Barazi Gjinore dhe Shoqatën për Zhvillim Rural dhe Lokal gjatë konferencës së fundit ka mbyllur projektin "**Përfshirja e Perspektivës Gjinore në Politikat Kryesore të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**", që është financuar nga Bashkimi Evropian. Pas hulumtimit të zbatuar dhe analizës që është e gatshme në tre gjuhë (maqedonisht, anglisht dhe shqip) <http://rural.mk/cornerstone-draft-5/> ishin miratuar disa konkluzione kryesore ose drejtime për veprimin e mëtutjeshëm në sektorë që ishin drejtuar për:



- rregullim të pjesës së pushimit të lindjes për gratë të regjistruar si fermerë individual;
- krijimi i masave afatgjate dhe programeve për përfundim të barazisë gjinore me anë të mundësive për pjesëmarrje publike të grave nga mjediset rurale në proceset e krijimit të politikave dhe vendimeve, por edhe të zbatimit të tyre në teren;
- nxitje të pro aktivitetit institucional si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në nivelin lokal në pjesën e përfshirjes së komponentit gjinor, por edhe sensitivitetit gjinor gjatë krijimit të politikave lokale dhe kombëtare;
- të mundësohet shpërndarje e vazhdueshme e informacioneve lidhur me inkluzionin ekonomik dhe social të grave nga mjediset rurale;
- të mundësohet koordinim mes sektorëve dhe institucioneve dhe bashkëpunim mes palëve të interesuara (institucione, komuna, agjenci, gra fermerë, OJQ tjera të lidhura me çështjet që kanë të bëjnë me këtë kategori të qytetarëve), etj.
- të investohet më tutje në infrastrukturën e mjedisve rurale dhe si të rritet përfshirja e shërbimeve që janë të gatshme për gratë në mjediset rurale.



Zëri i të rinjve rural në Maqedoninë e Veriut

Më 29 maj 2019, në Shkup, projekti i financuar nga BE-ja "Të Rinjtë Rural Ndhimjnë Maqedoninë e Veriut për Integrim në BE" i zbatuar nga Fondacioni CNVP dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë, ka organizuar ngjarjen e fundit në të cilën kanë marrë pjesë ri rinjtë që ishin pjesë e trajnimit për trajnerë në kuadër të projektit, të gjitha organizatat që kanë pasur rol në zbatimin e projektit, mësime dhe shkollave të mesme, organizatat rinore dhe përfaqësues të komunave dhe organizatave publike. Aktivitetet e zbatuara të projektit dhe leksionet e mësuara ishin prezantuar gjatë kësaj ngjarjeje, si dhe ishte bërë një përmbledhje e rekomandimeve nga të rinjtë nga rajoni Lindor dhe Jug-Lindor në të cilat edhe ishin zbatuar aktivitetet. Një vëmendje e veçantë ishte dhënë Manualit për Aktivizëm Rinor që ishte përgatitur nga eksperti i ri Antonio Danillovski. Ky manual është produkt i projektit dhe shërben si udhëzues për të ndihmuar facilitatorët, trajnerët dhe ekspertët që punojnë në fushën e aktivizimit rinor, të shpërndajë dhe të zbatojë programe për të rinjtë që janë të interesuar për të bërë ndryshime në komunitatet e tyre, qytet dhe gjithë territorin e shtetit. Ngjarja ishte pasuruar nga përfaqësuesit e partnerëve të projektit nga rrjetet e zhvillimit rural të Serbisë dhe Kroacisë, që kanë dhënë shembuj pozitiv të projekteve të zbatuara për të rinjtë dhe veprimet për aktivizëm rinor. Përfaqësuesi i Klubit për të Rinj nga Shtipi dhe partner i projektit, Dragana Mirkoviq, ka prezantuar mbi qëndrueshmërinë e projektit me anë të platformës së krijuar nga nënshkrimi i deklaratës për bashkëpunim me organizatat e rajonit ligjor dhe juglindor. Kjo ishte plotësuar me një diskutim për të rinjtë e synuar dhe rëndësia e këmbënguljes për përfaqësim të interesave të tyre. Në fund, kryesuesi i projektit Saso Petrovski ka shpërndarë njohuri për pjesëmarrje dhe kontribut të gjerë për zbatimin e projektit organizatave CELOR nga Radovishi, Klubit për të Rinj nga Shtipi, Horti Eko nga Strumica, Agjencia Kombëtare për Mobilitet dhe Arsim, dhe aktivisti më i ri dhe pjesëmarrësit të projektit Slobodanço Gorgiev nga Vinica. Kjo ngjarje ishte moderuar nga Biljana Vasilevska-Trajkovska, përfaqësuese e Këshillit Kombëtar për të Rinj i Maqedonisë.



Figurë informative për rezultatet e projektit

Mbi rrjedhjen e projektit, rezultatet e aktiviteteve dhe leksionet e mësuara dhe rekomandimet e përmbledhura ishte përpiluar një figurë informative me të dhënat themelore.

Për më tepër informacione, vizitoni <http://ruralnet.mk/wp-content/uploads/2019/05/Infografik.pdf>





Pjesëmarrja e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RBZHR) në rrjetin – Konferenca për Inspirim të Evropës Rurale

11-12 prill 2019 – Bruksel, Belgjikë

Më datën 11/24/2019 deri më 12/04/2019 ishte organizuar mbledhja më e madhe e komunitetit të rrjetit për Evropë rurale në Bruksel. Me titullin “networX” – Inspirimi i Evropës Rurale, qëllimi i konferencës ishte që të njohë vlerat e rrjetëzimit për zhvillim rural, të demonstrojnë rezultatet e dhjetë viteve të fundit të rrjetëzimit rural dhe në mënyrë pro aktive të punojë për të ardhmen. Formatu interaktive ka siguruar një hapësirë të mjaftueshme dhe kohë të mjaftueshme për diskutime joformale, për inspirim të diskutimeve dhe shembim të përvojave, ri-afirmim të vlerave të lidhjeve njerëzore në botën digjitale. Mbi 400 aktorë rural nga gjitha Evropa janë mbledhur për të diskutuar pikat vijuese:

- Roli i rrjetëzimit për politika rurale
- në çfarë mënyre të krijohet/transformohet rrjeti
- rrjetëzimi për inovacione në bujqësi dhe vise rurale
- LEADER/CLLD rrjetëzimi
- rrjetëzimi për vlerësim
- promovimi i angazhimit efektiv të aktorëve në rrjetet

Rrjeti për Zhvillim Rural i vendeve të BP-së si pjesë e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Kosova) kanë marrë pjesë në këtë ngjarje, të organizuar nga pika e kontaktit të Rrjetit Evropian për Zhvillim Rural. Rrjetet nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia, si pjesë e IPARD vendeve ka pasur mundësi për të prezantuar të prezantojnë punën e tyre si ekspozues të stendave në treg ndërsa Kosova dhe rrjetet nga Bosnja dhe Hercegovina kanë marrë pjesë si vizitorë. Përveç aktiviteteve individuale të IPARD rrjeteve, aktivitetet e RBZHR ishin prezantuar në tregun me anë të shfaqjes së afishes dhe prezantimeve dhe diskutimeve individuale me pjesëmarrësit.





Takimi i RBZHR me EU DG – Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Gjatë ngjarjes, RBZHR ka pasur një takim të ndarë me DG-Agri për të diskutuar mbi Rrjetet në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Ishin diskutuar pikat vijuese:

- Gjendja aktuale e Ndhmës Teknike në kuadër të IPARD në secilin vend, dhe mundësia për të financuar rrjetet rurale me anë të IPARD
- Rrjetet Rurale – të ndarë ose në kuadër të Ministrisë – dy zgjidhje të mundshme
- Mundësi tjera të burimeve të financimit (në NT nuk është akredituar ende)
- Shtrirja e punës (prioritetet tematike) të Rrjeteve nga IPARD vendet

Përfaqësuesit e DG-Agri (z-sha Anna Nowak-Wood, Kryesuesi Programor për Serbi; dhe z-sha Iwona Lisztwan, Kryesuesi Programor për Turqi) kanë theksuar rëndësinë dhe rolin e rrjeteve për mbështetjen e zbatimit të IPARD. Ishte theksuar që mbështetja financiare e rrjeteve duhet të sigurohet me anë të masave për ndihmë teknike në ato vende që është përfunduar akreditimi, dhe ato që nuk kanë këtë akreditim, duhet të gjejnë mënyra tjera të financimit. Ky është rasti me mbështetjen qeveritare vetëm në Turqi

ku Rrjeti Kombëtar për Zhvillim Rural është financuar vetëm nga masa e ndihmës teknike. Një shembull i punës së suksesshme ishte dhënë nga rrjeti i Turqisë gjatë prezantimit për LEADER dhe NT në Turqi.

Petar Gjorgievski ka falënderuar Drejtorinë për mbështetjen dhe ka theksuar që të gjitha rrjetet me anë të Komitetet e Monitorimit të IPARD do të propozojnë zgjidhje para ministritë relevante për themelimin dhe financimin e rrjeteve kombëtare dhe mbështetje të qasjes LEADER. Ai theksoi që Ndhma Teknike në Maqedoni është e akredituar por ende nuk ka fonde për themelimin e Rrjetit Kombëtar Rural. Ai theksoi që për dallim nga rrjeti në Turqi, rrjetet e Ballkanit Perëndimor me anëtarët e RBZHR janë në fakt organizata civile dhe kanë një shtrirje më të gjerë të veprimit përveç IPARD, si integrimi në BE, demokraci, decentralizimi, përfaqësimi dhe lobimi, të udhëzuar nga parimet nga poshtë-lartë. Më tutje, ministritë relevante ende nuk e pranojnë rëndësinë e rrjetëzimit dhe ata duhet të punojnë më afër me rrjetet civile për procesin e themelimit dhe funksionimit të Rrjeteve Kombëtare për zbatimin më të mirë të programeve për zhvillim rural, varësisht nga ajo se në çfarë mase ose niveli dëshirojnë të përfshijnë OJQ-të dhe çfarë modeli të rrjetit do të zgjedhin. Këto rekomandime ishin të pranuar nga DG-Agri dhe ishte ofruar mbështetje për të rritur bashkëpunimin dhe dialogun mes ministrive relevante dhe rrjetet.

